



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Perkthim Terminologjik A-B

Ngarkesa në orë/kredite: 40 orë mësimore; 4 kredite; . 30 leksione / 10 seminare
Viti / Semestri : Viti II, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor në “Përkthim dhe interpretim në gjuhën greke dhe angleze”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Ky kurs synon të njohë studentët me studimet e përkthimit si disiplinë të veçantë në fushën e terminologjisë, juridike, ekonomike, mjekësore, social-kulturore, dhe publicistikë. Duke e trajtuar gjuhën si sistem, duke trajtuar përkthimin si proces dhe si produkt, si dhe duke ndërthurur zbërthimin, interpretimin dhe qasjen e tekstit, jo vetëm në nivelin mikro, por edhe në nivelin makro, do t’u shërbejë studentëve të mund të strukturojnë dhe të përcjellin në gjuhën greke efekte të barasvlershme, ose të përafërta, në atë masë që lejojnë mjetet gjuhësore shprehëse të shqipes e të greqishtes, si dhe faktorë të tjerë gjuhësorë e jashtëgjuhësorë. Nëpërmjet materialit gjuhësor problemor autentik, në përputhje me nivelin e njohurive të përfuara gjatë dy viteve të para e të gjitha zhanreve, stileve e regjistrave, si të gjuhës së shkruar e asaj të folur, do të mundësohet përfshirja dhe ndërthurja me studimet Helenike, në mënyrë që studentët të njihen jo vetëm me gjuhën por edhe me jetën, kulturën, qytetërimin, institucionet etj.,.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.T’i njohë studentët me studimet e përkthimit si disiplinë e veçantë terminologjike.
- 2.T’i ndërgjegjësojë studentët në lidhje me rolin e përkthimit në procesin e komunikimit dhe ndërthurjen e tij në procesin e mësimdhënies dhe nxënies së gjuhës greke nëpërmjet zhvillimit të kompetencave të ndryshme disiplinore, ndërdisiplinore dhe shumëdisiplinore. Në këtë kontekst, nëpërmjet trajtimit në planin praktik dhe teorik të dukurive gramatikore, leksikore dhe stilistike të gjuhëve shqip e greqisht, bazuar në parimin ‘pa probleme përkthimore, nuk mund të ketë teori përkthimi’, mendohet dhe shpresohet që studentët të vendosin dhe të krijojnë një lidhje organike ndërmjet lëndëve të ndryshme dhe përkthimit në aspektin praktik dhe aplikativ në këndvështrimin e marrëdhënieve shumëdisiplinore dhe ndërdisiplinore